



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:144399  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05498559

**AC.nr.3609/22**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Feka-Kryetar i Kolegjit, Frosina Sylejmani dhe Naime Ahmeti antarë të kolegjit, në çështjen juridiko-civile të paditësve V. I., H. I. dhe Z. Is., të gjithë nga fshati S./Komuna e S., të cilët me autorizim i përfaqëson av. R. G. nga Suhareka, kundër të paditurës B. K. e S.(BKS) me seli në P., me objekt të çështjes kontestimore kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, B. K. e S. me seli në P., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.351/18 të datës 06.02.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me atën **25.03.2024**, nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.REFZUOHET SI E PA BAZUAR** ankesa e të paditurës B. K. e S. me seli në Prishtinë, ndërsa, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.351/18 të datës 06.05.2022, sa i përket pikës **I, II** dhe **IV** të dispozitivit të tij, **VËRTETOHET**.

**II.Pika III** e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm, me numër C.nr.351/18 të datës 06.05.2022, **ngel e pa shqyrtuar**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Suharekë, Departamenti i Përgjithshëm me Aktgjykimin C.nr.351/18 të datës 06.05.2022, ka gjykuar si në vijim:

**I.APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses: V. I., ashtu që detyrohet e paditura B. K.e S. (BKS) me seli në P., që në emër të dëmit material dhe atij jo material, t'ia kompensoj paditëses shumat si në vijim:

për dhimbje fizike (trupore) dhe kategoritë e saj shumën prej 3000 euro  
për frikën e përjetuar, kategoritë e saj, shumën prej 1500 euro  
për shëmtimin e pësuar nga aksidenti shumën prej 4000 euro  
për shkallën e invaliditetit, zvogëlim të aktivitetit jetësor prej 35 %, shumën e kapitalizuar prej 42,016.23 euro  
në emër të ndihmës së huaj për 30 ditë, shumën prej 500 euro  
për ushqimin e përforcuar për 30 ditë shumën prej 210 euro  
Për shpenzimet e mjekimit shumën 30 euro, të gjitha këto obligohet që ti paguaj e paditura në afatin prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

**II. APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve H. I. dhe Z. I., ashtu që **OBLIGOHET** e paditura që në emër të dhimbjeve shpirtërore t'ua kompensoj të dy paditësve shumën prej 4000 euro.

Pra, shuma e tërësishme për të tre paditësit V. I., H. Is. dhe Z. I., të vendosur si në pikën I dhe II të këtij dispozitivi është 54,756.23 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila për dëmin material fillon të rrjedh që nga dita parashtrimi të padisë datë 3.7.2018 e deri në përmbushjen definitive, ndërsa për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit datë 6.5.2022, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën nën përmbarim të dhunshëm.

**III. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë, respektivisht dallimi mbi shumën e aprovuar si në pikën një dhe dy të këtij dispozitivi, REFUZOHET SI E PABAZUAR.**

**IV. OBLIGOHET** e paditura, që t'ia kompensoj paditësve shpenzimet procedurale dhe atë në shumën e përgjithshme prej 4,008.00€ (katërmijë e tetë euro), brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor ankesë ka parashtruar e paditura B.K. e Si., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën di të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e ankimuar duke i zvogëluar shumat për paditësen V.I., ndërsa duke e refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve H. dhe Z. Is. dhe me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë shpenzimet e procedurës të gjykohen vetëm për paditësen V. I.

Paditësit kanë ushtruar përgjegje në ankesë duke i kundërshtuar në tërësi si të ba bazuara pretendimet ankimore të të paditurës me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzojhë anksën si të pa bazuar ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet në tërësi.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas shqyrtimit, analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 194, 195 par.1, pika (d) në lidhje me nenin 200 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e të paditurës B. K. e S. me seli në Prishtinë, rezulton e pa bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se paditësja V. I., përmes përfaqësuesit të autorizuar Refki Gega, avokat nga Suhareka, me datën 03.07.2018, ka ushtruar padi për kompensim dëmi kundër të paditurës B. K. të S. për shkak të aksidentit të pësuar datë 24.12.2017 nga i cili aksident paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore. Në fjalën përfundimtare, në seancën e datës 14.03.2022 i autorizuari i paditësve e ka precizuar kërkesëpadinë e paditësve pas nxjerrjes së ekspertizave përkatëse, duke kërkuar që paditëses për dhembjet fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë, të rëndë, të mesëm, dhe të ulët kërkoj shumën totale prej 5,500.00 euro, për frikë primare dhe sekondare shumën totale prej 2,500 euro, kompensimin për shëmtimin shumën prej 7,000.00 euro, kompensimin për shkallën e invaliditetit prej 35% për ZVJ të llogaritur nga aktuari shumën e kapitalizuar prej 42,016.23 euro, kompensimin për ndihmën e huaj 30 ditë 500 euro, për kompensimin për ushqim të përforcuar 30 ditë 210 euro, për kompensim për rehabilitim fizioterapeutik shumën prej 600 euro, për kompensim për shpenzime të mjekimit, 2,000.00 euro. Po ashtu, ka kërkuar kompensimin për dhembjet shpirtërore, për prindërit e paditëses H.I., shumën prej 10,000 euro dhe për nënën Z.I. shumën prej 10,000.00 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë shumën prej 4,008.00 euro.

E paditura, B. K. e S. përmes përgjigjes në padi të datës 27.01.2020, nuk e ka kundërshtuar bazën e kërkesëpadisë, por e ka kundërshtuar lartësinë e saj për faktin se padisë pala paditëse nuk ia ka bashkangjitur provat mbi bazën e të cilave do të vërtetohej lartësia e kërkesëpadia, ndërsa në fjalën përfundimtare të datës 14.03.2022, e paditura ka theksuar se mbetet në tërësi pranë ofertë së dhënë në emër të dëmit material dhe jo material në vlerë prej 16,500.00 euro, edhe më tutje për të paditurën mbetet kontestues dëmi material sa i përket fitimit të humbur, për faktin se fillimisht kjo kategori e dëmit në bazë të rregullores për trajtimin e dëmeve jo materiale nga auto përgjegjësia është caktuar se përlllogaritet vetëm në rastet kur ZVJ është mbi 30%. Po ashtu edhe për faktin se pala paditëse nuk e ka argumentuar këtë kategori të dëmit me prova si: vërtetimi se paditësja nuk është përfituese e ndonjë skeme sociale qoftë në Kosovë ose në shtetin e Sllovenisë, po ashtu vërtetimin se e njëjta është në evidencën e të papunëve si në Kosovë e po ashtu edhe në Slloveni, ku një kërkesë e tillë është paraqitur edhe nga eksperti aktuar, Aziz Berisha, i cili ka theksuar se llogaritja e tij në emër të dëmit material – fitimit të humbur vlen vetëm në rast se paditësja është e papunë dhe nuk është përfituese e ndonjë skeme sociale. Po ashtu e paditura e ka kundërshtuar edhe kompensimin për dy paditësit tjerë, prindërit e paditëses të cilët kanë kërkuar kompensimin për dhimbje shpirtërore, duke u thirrur në faktin se në rastin konkret kërkesa e tyre është parashkruar.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë, ka caktuar senacë gjyqësore dhe pas nxjerrjes dhe administrimit të provave në shkresat e lëndës, ka nxjerr aktgjykimin e ankimuar C.Nr. 351/18 me vendosje më të hollësishme si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në arsyetimin e saj, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga Raporti i aksidentit të Policisë së Kosovës, procesverbalin e aksidentit të lëshuar nga policia e Kosovës 2017-GR- 0997, datës 24.12.2017 u vërtetur fakti paditësja me datë 24.12.2017 ka pësuar aksident komunikacioni në rrugën Suharekë-Prishtinë, përkatësisht në vendin e quajtur “Grykën e Carralevës”, ku nga ky aksident ka pësuar lëndime të rënda trupore. Nga raporti mjekësor i lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren, Emergjencia, me nr. protokollit 15274 të datës.24.10.2017, vërtetohet se paditësja

është pranuar me lëndime të rënda trupore, ndërsa nga flete lëshimi lëshuar nga QKUK Prishtinë, nr. të anamnezës 3069 gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qëndruar prej datës 24.12.2017 deri më datë 09.01.2018 në Klinikën e Syve Prishtinë. Nga prova tjetër flete lëshimit e lëshuar nga QKUK Prishtinë nr. 60, reparti i traumatologjisë, lokomotorë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja në fjalë ka qenë e shtruar në këtë repart prej datës 09.01.2018, për shkak të lëndimit të parakrahut të anës së djathtë. Nga ekspertiza mjekësore e ekspertit oftamolog dr. Gafur Murati dhe eksperti maxilofacial dr. Njazi Heta gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka pësuar këto lëndime: shëmtim trupor të shkallës së lartë për shkak të zvogëlimit të kokërdhokut të syrit të djathtë, zvogëlim të aftësisë së përgjithshme jetësore në shkallën prej 25 %, përfundimisht e ka humbur shikimin me syrin e djathtë, ndërsa i vetmi tretman që mund të bëjë paditësja është i aspektit estetik, ose vendosjes së protezës, e cila mund të vendoset vetëm jashtë Kosovës. Po ashtu sipas kësaj ekspertize është konstatuar se paditësja ka shëmtim të lartë për shkak të humbjes së syrit, ku i njëjti është më i tkurrur. Nga prova, ekspertit ortoped – traumatolog dr. Rrahman Shala datës 24.03.2021 gjykata ka vërtetuar faktin paditësja me rastin e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore për shkak të thyerjes së parakrahut të djathtë, nuk ka zvogëlim të aktivitetit jetësor, për shkak se thyerja ka ndodhur jashtë dy njejeve të bërrylit dhe të dorës. Akt ekspertiza mjeko ligjore për prokurorinë e shtetit nga eksperti Musa Gashi, me nr. PP.nr. 294-9/18 ka përcaktuar se paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore. Nga ekspertiza psikiatrike Dr. Naim Fanaj, vërtetohet se paditësja me rastin e aksidentit nuk ka pësuar frikë primare për faktin se e njëjta me rastin e aksidentit nuk e ka vërejtur drejtpërdrejt aksidentin, deri tek ky konstatim eksperti ka ardhur në sajë të ekzaminimit të drejtpërdrejtë, ndërsa e njëjta ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dy muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ultë ka vazhduar rreth një vit. Andaj gjykata kësaj prove ia fali besimin për faktin se e njëjta është hartuar në sajë të ekzaminimit të drejtpërdrejtë, si dhe e njëjta ndërlihet edhe me provat tjera mjekësore dhe ekspertizat e lartcekura. Nga ekspertiza e ekspertit të punës të punës dr. Xhevad Shkodra të datës 20.10.2021, vërtetohet se paditësja ka zvogëlim të aktivitetit jetësor prej 35 % për shkak të verbërimit total të njërit sy, bazuar nga tabelat e përgjithshme të zvogëlimit të aktivitetit punues vlerësohet prej 33%, po ashtu edhe vlerësimi për lëndimet nga dora prej 2.5% në total rrjedh prej 35% zvogëlimit të aktivitetit punues, pra sipas mendimit të ekspertit paditësja rangohet në shkallën e dytë të invaliditetit të punës. Ndërsa lidhur me konstatimin e faktit për fitimin e humbur nga data e aksidentit e deri në moshën 65 vjeçare, gjykata këtë fakt e ka vërtetuar nga prova, ekspertiza e ekspertit të aktuaristikës dr. Aziz Berisha, e datës 30.11.2021 i cili ka theksuar se fitimi i humbur tek paditësja prej datës së aksidentit 24.12.2017 e deri më datë 30.11.2011 arrin vlerën prej 7,306.54 euro, ndërsa për periudhën prej datës 01.12.2021 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore, renta mujore do të jetë nga 123.61 euro, kurse renta e kapitalizuar kap shifrën prej 42,016.23 euro. Nga deklarate e datës 28.05.2021 e paditëses e vërtetuar te noteri Minir Zekolli në Suharekë, me nr. LRP.nr. 6403/2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësja për aksidentin në fjalë nuk është kompensuar nga shteti i Sllovenisë, për faktin se e njëjta jeton në këtë shtet. Kësaj prove gjykata ia fali besimin për faktin se të kundërtën e saj ka mundur që ta argumentonte pala e paditur po që se e njëjta do të prezantonte prova tjera. Nga kupomni i datës 30.1.2018, lëshuar nga Eye Hospital, gjykata vërtetoi faktin e kontrollës mjekësore tek spitali i syrit, ku paditësja ka paguar për këtë kontroll mjekësore shumë prej 30 euro. Duke marrë parasysh dëmin që i është shkaktuar paditëses gjykata e aprovoj pjesërisht të bazuar

kërkesëpadinë e paditëses si në pikën e I-rë të dispozitivit duke theksuar se lartësia e shumave në emër të kompensimit do të jetë vetëm një satisfaksion që paditësja të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat është privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta shfrytëzonte nëse të njëjtat nuk do t'i kishin humbur. Të gjitha këto duke pasur parasysh rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojat e shtuara të ushqimisë, si dhe shkallën e shëmtimit të lartë për shkak të humbjes së syrit, shto këtu edhe moshën e re të saj 25 vjeçare. Gjykata vendosi si në pikën e II-të dispozitivit, ku për paditësit H. I. dhe Z. I. (prindërit e paditëses), në emër të dhimbjeve shpirtërore t'ia paguaj shumën prej 4000 euro, për faktin se gjykata vlerëson se ky lloj kompensimi është vetëm satisfaksion moral i kompensimit, pra me këtë lloj kompensimi nuk mund të shpaguehen dhimbjet shpirtërore të prindërve për shkak të gjendjes shëndetësore pas aksidentit që ka pësuar vajza e tyre. Ndërsa sa i përket bazës së kërkesëpadisë së a kanë të drejtë të kompensohen edhe prindërit e paditëses kërkesa e tyre bazohet sipas nenit 184 paragrafi 3 të LMD-s, i cili përcakton se, citojmë: *“Në rast të invaliditetit tejet të rëndë ose shëmtimit në shkallë të lartë të ndonjë personi, gjykata mund tu caktojë bashkëshortit, fëmijëve dhe prindërve shpërblim të drejtë në të holla për dhembjet e tyre shpirtërore”*, pranë rastin konkret nga provat mjekësore të administruara është vërtetuar fakti se paditësja ka pësuar lëndim të shkallës së rëndë. Gjykata, vendimin e bazoi në nenin 136, nenit 159 nenin 169 paragrafi 2, nenit 183 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve 04/L-077 lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), nenit 362 paragrafi 3 të LMD-s dhe sipas Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, ku është paraparë që *“Sigurimi nga auto përgjegjësia mbulon: 1.1. dëmet në persona dhe pasuri të shkaktuara palëve të treta nga përdorimi i mjetit motorik. 1.2. dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik, përfshinë gjithashtu dëmin e shkaktuar palëve të treta përmes gjësendeve të cilat bien nga mjetet motorike apo çdo gjë tjetër që është i lidhur me mjetin motorik. 1.3. dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit motorik palëve të treta nga drejtuesi i paautorizuar i mjetit motorik”*. Vendimin për sa i përket kamatës ligjore e mori duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës vendosi sipas nenit 452 të LPK-së

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron pjesërisht të drejtë dhe të ligjshëm, aktgjykimi i ankimuar edhe pse nuk është i shoqëruar me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, par.2 pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, për të cilat, gjykata e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as në shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese sipas nenit 182 par.1, dhe se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, në pjesën e refuzuar të ankesës së të paditurës. Aktgjykimi i ankimuar në pjesën e vërtetuar me këtë aktgjykim, nuk është i shoqëruar as me shkelje tjera të pretenduara nga pala ankuese nga neni 182, par.2 pika (n) në lidhje me nenin 160 par 4 dhe 5 të LPK-së, për mënyrën e vendosjes janë dhënë arsye të mjaftueshme të cilat janë në lidhje harmonike dhe logjike me provat në shkresat e lëndës, mirëpo e drejta materiale është zbatuar gabimisht sa i përket pikës I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar për sa i përket lartësisë së kompensimit për shkallën e invaliditetit, dhe në këtë pjesë, rezulton e bazuar ankesa e të paditurës, ashtu që, kemi zbatim të gabuar të së drejtës materiale, andaj Gjykata e Apelit e ndryshon pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, sa i përket shumave të gjykuara si në pikën I të aktgjykimit të ankimuar në shumat e gjykuara është në përputhje të plotë dhe proporcionale me lëndimet trupore të paditësve të cilat kategorizohen si lëndime të rënda trupore me pasojat e përshkruara si në dispozitiv, ku është konstatuar se paditësja V. I. ka pësuar lëndime të rënda trupore nga të cilat ka pësuar frikë primare për faktin se e njëjta me rastin e aksidentit nuk e ka vërejtur drejtpërdrejt aksidentin, po ashtu, e njëjta ka pësuar frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 24 orë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm dy muaj dhe frikë sekondare të intensitetit të ultë ka vazhduar rreth një vit, e gjithashtu edhe dhimbje fizike të cilat janë konstatuar nga eksperti i lëmisë së ortopedisë-traumatologjisë, si dhe eksperti i ofalmologjisë dhe i kirurgjisë maksillofaciale të cilët kanë dhënë konstatimet e tyre lidhur me syrin e djathtë të dëmtuar të paditëses nga i cili ka rrjedh se paditësja V. I. përfundimisht si pasojë e aksidentit ka humbë syrin e djathtë të, gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se shumat e gjykuara si për dëmin material ashtu edhe jo material, janë në përputhje të plotë me nenin 169, dhe 183 të LMD-së, si dhe standardet e krijuara në praktikën gjyqësore për lartësinë e kompensimit të gjykuar për këto kategori të dëmeve në raport me pasojat e shkaktuara tek paditësit, prandaj, gjykata e shkallës së parë, vlerëson se shumat e gjykuara në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, për pjesën e refuzuar të ankesës së të paditurës janë të drejta ekuivalente dhe në proporcion të plotë me pasojat shëndetësore që paditësit i kanë pësuar në aksidentin e komunikacionit, e të cilat shuma mjaftueshëm përbëjnë zhdëmtim për paditësen dhe rehabilitimin e pasojave nga aksidenti.

Gjithashtu, edhe shuma e gjykuar në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar për paditësit H. dhe Z. I. (prindërit e paditëses V. I.), sa i përket dhimbjeve shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor të fëmiut të tyre këtu V. I., janë reale dhe proporcionale, ku të njëjtat shërbejnë si satisfaksion për dhimbjet shpirtërore që prindërit i përjetojnë në rastin konkret për shkak të lidhjes emocionale që të njëjtit kanë me vajzën e tyre V. Is., duke marrë parasysh ndjeshmërinë që të njëjtit e përjetojnë ndaj fëmiut të tyre, dhimbjet shpirtërore të përjetuara dhe që vazhdojnë të përjetojnë për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe punues për paditësen për shkak të humbjes së plotë të shikimit të syrit të djathtë, janë shuma reale dhe të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë, në kuptim të nenit 184 par.3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, dhe duke marrë për bazë shkallën e lartë të shëmtimit që paditësja ka pësuar sipas konstatimit të ekspertit mjekësor dhe shkallës së invaliditetit të rëndë që ka pësuar paditësja, drejtë ka gjykuar edhe shumën si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Gjithashtu, edhe lidhur me rentën e kapitalizuar të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë rrjedhojë e fitimit të humbur që paditësja që nga data e aksidentit e deri në moshën 65 vjeçare, në shumë totale prej 42,016.23 euro, duke marrë për bazë faktin se nga konstatimi i ekspertit specialist të mjekësisë në punë Xhevat Shkodra të datës 20.10.2021 është vërtetuar fakti se paditësja V. I. për shkak të aksidentit, lëndimeve të pësuar, ka zvogëlim të aktivitetit punues në shkallë prej 35%, dhe i njëjti në sqarimet shtesë, theksuar se paditësja bazuar nga provat tjera mjekësore ku është konstatuar verbërimi total i njërit sy, bazuar nga tabelat e përgjithshme të zvogëlimit të aktivitetit punues vlerësohet prej 33%, po ashtu edhe vlerësimi për lëndimet nga dora prej 2.5% në total rrjedh prej 35% zvogëlimit të aktivitetit punues, dhe e njëjta rangohet në

shkallën e dytë të invaliditetit të punës, dhe nga ky konstatim i ekspertit të mjekësisë në punë, duke marrë për bazë edhe faktin se e njëjta është e pa punë dhe vlerësimi i rentës në formë të fitimit të humbur është marrë duke iu referuar pagës minimale që realizohet në vendin tonë, si dhe referuar mendimit aktuar të ekspertit Aziz Berisha i datës 30.11.2021, ku i njëjti ka konstatuar se fitimi i humbur tek paditësja V. I. prej datës së aksidentit 24.12.2017 e deri më datë 30.11.2011 arrin vlerën prej 7,306.54 euro, ndërsa për periudhën prej datës 01.12.2021, e tutje renta mujore do të jetë 123.61 euro, apo shuma e kapitalizuar e rentës 42,016.23 euro, andaj, referuar nenit 178 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe fakteve të vërtetuara më lartë, drejtë është vendosur edhe për rentën e kapitalizuar për paditësen V. I..

Gjithashtu, sa i përket kamatëvonesës, gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar të drejtën materiale, ku i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077, si dhe momentit të përcaktimit të rrjedhjes së saj, dhe kjo vendosje pranohet edhe nga gjykata e shkallës së dytë, ngase është në përputhje edhe me Mendimin Juridik për Kamatën të miratuar nga Gjykata Supreme e Kosovës nr. 265/20, datës 01.12.2020, gjegjësisht pikën II, V dhe XIV dhe XV të këtij mendimi, ku përcaktohet ligji i aplikueshëm, shkalla e kamatëvonesës dhe periudha e rrjedhjes së saj dhe vendosja nga gjykata e shkallës së parë është në përputhje me këto pika, ka gjykuar shkallën e kamatëvonesës prej 8% vjetore nga data e ushtrimit të padisë për dëmin material ndërsa për dëmin jo material nga data e nxjerrjes së aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë, e të cilën vendosje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjithashtu, edhe vendosja lidhur me shpenzimet e procedurës, rezulton të jetë e drejtë dhe në përputhje me nenin 452 të LPK-së, në kuptimin e detyrimit sa i përket lartësisë së shpenzimeve procedurale e cila bie në barrë të paditurës. Kurse shpenzimet e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë janë proporcionale dhe në harmoni të plotë me suksesin e pjesërishëm që paditësit kishin në procedurë.

Meqenëse, pika **IV** e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar me ankesë, konsiderohet se nuk është atakuar me ankesë(duke marrë parasysh interesin juridik të parashtruesit të ankesës), në kuptim të nenit 194 të LPK-së (kufinj të ekzaminimit të ankesës), si dhe nenit 203 të LPK-së, “Insitutitit Reformatio in Peius”, gjykata e shkallës së dytë, nuk e shqyrtoi pikën **IV** të dispozitivit të aktgjykimit të kundërshtuar me ankesë

Prandaj, Gjykata e Apelit, mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 194, 195, par.1, pika d), në lidhje me nenin 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AC.nr.3609/20, data 25.03.2024**

**Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari**  
**Besnik Feka**

Numri i lëndës: 2019:144399  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05498559